

Aplikimi për vizë me qëllim punësimin si profesionist sipas Ligjit për emigrimin e profesioneve të kualifikuara

Ju lutemi, lexojeni këtë fletë udhëzuese dhe formularin e aplikimit me kujdes dhe plotësoni me përpikmëri kriteret.

Aplikimet e paplota ose dokumentacioni i paplotë mund t'ju çojnë drejt refuzimit të aplikimit. Në këtë rast, do t'ju duhet të regjistroheni për një takim të ri dhe të respektoni kohën e caktuar të pritjes.

Udhëzim i rëndësishëm: Me profesione të kualifikuara kuptojmë çdo aktivitet/punë diploma e së cilës është e njohur në Gjermani. Përsa i përket certifikatave/diplomave të shkollave profesionale, këtyre duhet t'ju bashkangjitet dëshmia që janë të njohura nga zyra përkatëse gjermane. Diplomat e universiteteve duhet të kontrollohen përmes Anabin dhe të jenë të njohura në Gjermani.

Gjatë procesit të aplikimit, përveç ambasadës angazhohen edhe zyrat përkatëse në Gjermani. Procesi zgjat si rregull 2-4 javë, në rast të qëndrimeve të mëparshme në Republikën Federale, kjo procedurë zgjat edhe më gjatë. Ju lutemi të mirëkuptoni që nuk mund t'ju përgjigjemi pyetjeve tuaja për gjëndjen e dosjes suaj në 5 javët e para të aplikimit.

Dokumentat e mëposhtme ju nevojiten për aplikimin e sipërpërmendur:		
1.	Formularët e aplikimit	2 Formularë, në gjermanisht ose anglisht, të plotësuar me përpikmëri dhe të lexueshëm, të firmosur me shkrim dore.
2.	Tarifa e vizës	Tarifa e vizës pranohet vetëm në monedhën shqiptare Lekë para në dorë (cash). Tarifa prej 75,00 Euro varjon sipas kursit të këmbimit aktual.
3.	Fotografi pasaporte	3 fotografi identike biometrike për pasaportë , jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, përmasat 45 X 35 mm. Ju lutemi, tek secili formular ngjisni 1 fotografi dhe fotografinë e 3-të silleni me vete.
4.	Pasaporta	Të paktën 2 faqe boshe. Ju lutemi, kujdesuni që pasaporta juaj të jetë e vlefshme edhe 3 muaj pas afatit përfundimtar të vizës. Ju lutemi, sillni dy kopje të pasaportës suaj (faqja e plastifikuar me të dhënat tuaja). Si rregull, pasaporta juaj qëndron 2-3 javë në sektorin e vizave gjatë kohës së përpunimit të dosjes. Nëse juve ju duhet pasaporta mbrapsht, ju lutemi deklarojeni këtë në sportel gjatë aplikimit.

5.	Ofertë punë konkrete ose kontratë pune	Originalen dhe 2 kopje Ditën e aplikimit duhet të jetë jo me e vjetër se 6 muaj dhe me të dhënat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> • Lloji i aktivitetit/ përcaktimi i punës/ profesionit • Periudha që do të jeni i punësuar • Pagesa mujore bruto ose pagesa bruto për orë • Orët e punës në javë • Ditët e pushimit në vit
6.	Në rast se kërkohet: dëshmi të siguracionit të pensionit	Aplikuesit, duke filluar nga 45 vjeç, duhet të kenë një pagesë mujore prej të paktën 3.795,- Euro bruto (e vlefshme për vitin 2020) ose dëshmi të siguracionit të pensionit.
Diplomat universitare		
7a	Vërtetimi nga Anabin ose vlerësimi individual i diplomës së huaj universitare nga KMK	https://anabin.kmk.org/no_cache/filter/hochschulabschluesse.html
		OSE
7b	Dëshmi mbi lejen e ushtrimit të profesionit (për profesionet e rregulluara)	https://www.anererkennung-in-deutschland.de/html/en/simple_language.php
		OSE
Certifikatat/Diplomat e shkollave profesionale		
7c	Dëshmi për njohjen e certifikimit (diplomës) në Gjermani	https://www.anererkennung-in-deutschland.de/html/en/simple_language.php

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund t'ju kërkohen dokumenta shtesë të papërmendura më sipër.

Ju lutemi, vini re, se nuk keni asnjë të drejtë ligjore për të kërkuar lëshimin e vizës për punësim nga autoritetet që ndodhen në Gjermani, aplikimi behet vetem tek Ambasada Gjermane në Tiranë.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit në Gjermani, viza ju lëshohet me një kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj. Ju lutemi të udhëtoni në kohën e duhur në Gjermani dhe drejtohuni atje tek autoritetet përkatëse, të cilat merren me zgjatjen e lejes së qëndrimit dhe që janë autoritetet përkatëse kompetente për të gjitha çështjet tuaja ligjore si të huaj.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të ambasadës në momentin e hartimit të tyre.